



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni Pranveror

Komisioni për Integritim Evropian

Mbledhja nr. 24.

Prishtinë, më 23.07.2018 në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Donika Kadaj-Bujupi, Milaim Zeka, Ismajl Kurteshi, Fikrim Damka, Ilir Deda, Adem Hoxha dhe Visar Ymeri.

Mungoi: Fatmire Kollçaku.

E ftuar: Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian.

Staffi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësues nga GIZ-i, OSBE-ja, NDI-ja, KDI-ja, Zyra e BE-së dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 3.7.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian- e ftuar për të paraqitur këtë marrëveshje, znj. Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian;**

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-022 për Projektligjin për Ndërmarrje Sociale, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja, tha se në fund të javës se kaluar e kemi pranuar edhe Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”, andaj pasi kemi ministren të pranishme, propozoi që të shtohet edhe kjo pikë e rendit të ditës, në mënyrë që sot të shqyrtojmë edhe këtë projektligj dhe ta procedojmë për seancën plenare, sepse do të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar ngase është një marrëveshje shumë e rëndësishme për qytetarët e Kosovës.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se **Rendi i ditës** u miratua me propozimin për pikën e re të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 03.07.2018;

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian- e ftuar për të paraqitur këtë Marrëveshje, znj. Dhurata Hoxha, ministre e Integrimit Evropian;

Dhurata Hoxha, ministre e Integrimit Evropian, tha se kjo marrëveshje duhet të ratifikohet nga Kuvendi i Kosovës dhe fillimisht do t’ ju njoftojë si kemi ardhur deri te marrëveshja dhe çka përmban ajo.

Për shkak se në kuadër të programit IPA -2017 kemi edhe përkrahje sektoriale buxhetore për menaxhimin e financave publike, programi është ndarë në dy pjesë. Ne e kemi pjesën e parë dhe deri më tash MIE-ja ka kryer të gjitha procedurat dhe Marrëveshja financiare për IPA 2017 pjesa e parë është negociuar dhe nënshkruar më 1 qershor 2018, kurse është miratuar më 22 qershor dhe nëse nuk hyn në fuqi me këtë datë, atëherë fondet e dhuruara nga BE-ja, si pjesë e kësaj marrëveshjeje, në shumën prej 48 milionë euro, anulohen në mënyrë automatike.

Marrëveshja financiare rregullon zbatimin e programit IPA 2017 pjesa e parë, që përfshin 11 projekte, të cilat do të ndihmojnë në përafrimin me legjislacionin e BE-së, të drejtat e njeriut, eficientë e energjisë , ekonominë digjitale, sigurinë ushqimore si dhe përkrahjen më të mirë të lidhjes së arsimit me tregun e punës. Shuma totale e përfshirë në këtë marrëveshje është 49. 47 milionë € ku bashkëfinancimi nga ana jonë është me 1.47 milion € Në kuadër të demokracisë dhe qeverisjes që ka shumë totale prej 14. 8 mil. € do të përkrahët procesi i integritit evropian nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve institucionale për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit që do ta transponojë legjislacionin e BE-së në kuadër të legjislacionit të Kosovës.

Këtu përfshihen posaçërisht masat që do të mundësojnë zbatimin e obligimeve që dalin nga MSA-ja dhe ka shumë prej 6 mil.€ ndërsa me 3 mil. € BE-ja do të përkrahë financiarisht zbatimin e prioriteteve që dalin nga dialogu politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që kontribuojnë në procesin e normalizimit, si parakusht esencial në drejtim të integritit evropian.

Gjithashtu, do të përkrahët edhe qasja e Kosovës në programet e BE-së, me 0.8 milion € ku shuma kryesore do të shkojë për një asistencë teknike, për të mbështetur qasjen e aplikuesve në kuadër të këtyre programeve, një pjesë e shumës do të përdoret për rimbursim 90% të pagesës së qasjes së Kosovës, në kuadër të 4 programeve të zgjedhura për vitin 2018.

Tenderimi dhe kontraktimi do të kryhen në kuadër të Zyrës së BE-së në Kosovë, e cila është autoriteti kontraktues dhe ata janë të gatshëm për të filluar zbatimin, posa të hyjë në fuqi kjo marrëveshje .

Andaj ju si anëtarë të KIE, duhet t'i njoftoni kolegët tjerë deputetë që është me rëndësi që sa më parë të bëhet miratimi i kësaj marrëveshje, në mënyrë që mos të vonohet zbatimi i këtyre projekteve .

Kryetarja, në lidhje me Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, propozoi një amendament.

Amendamenti 1

Ne titullin e Projektligjit, para fjalës „ **Kosovës** “, të shtohet fjala „**Republikës së** ” dhe kjo vlen në tërë tekstin e Projektligjit .

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë;

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, u miratua së bashku me amendamentin e propozuar dhe do të procedohen për miratim në seancën plenare.

4. Shqyrtimi i Marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”.

Kryetarja, edhe lidhur me këtë marrëveshje propozoj dy amendamente :

Amendamenti 1

Ne titullin e Projektligjit, para fjalës „ **Kosovës** “, të shtohet fjala „**Republikës së** ” dhe kjo vlen në tërë tekstin e Projektligjit

Amendamenti 2

Ne tekstin e preambulës, fjala „**Projektligj**”, zëvendësohet me fjalën “**Ligj**” dhe teksti vazhdon si në projektligj .

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë;

Rekomandim

Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”, u miratua, së bashku me dy amendamentet e propozuara dhe do të procedohen për miratim për seancën plenare.

Kryetarja, në vazhdim kërkoi nga ministrja, të diskutojnë për procesin e liberalizimit të vizave, proces ky për të cilin tha se ka qenë një angazhim i madh dhe i gjatë i institucioneve tona, në përmbushjen e kriterëve të vëna nga ana e BE-së për Kosovën.

Në këtë proces rol të rëndësishëm pati edhe Kuvendi i Kosovës, në përmbushjen e kriterëve si dhe Komisioni për Integritet Evropian.

Tashmë e kemi raportin pozitiv nga Komisioni Evropian për procesin e liberalizimit të vizave, prandaj, në lidhje me këtë proces, dëshiroj të di se cilat janë pritjet dhe veprimet të cilat planifikoni t’i ndërmerri, pasi siç e dimë, rekomandimi i Komisionit Evropian është vetëm hapi i parë në procesin vendimmarrës të institucioneve të BE-së.

Po ashtu, dëshiroj të di nëse keni ndonjë pozicion paraprak të shteteve anëtare të zonës Shengen, në lidhje r me votimin në Këshill.

Dhurata Hoxha, ministre, fillimisht tha që është një lajm i mirë që ne pranuar nga komisioni Evropian, që Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret në lidhje me liberalizimin e vizave, por ky është veç hapi parë, kurse hapi tjetër është në Komisionin LIBE, në Komisionin për të drejtat e qytetarëve, që vepron në kuadër të Parlamentit Evropian dhe takimi është paraprak të mbahet më 29 gusht, ku kryesuese do të jetë znj. Tanja Fajon.

Në bisedë me te dhe eurodeputetë të Komisionit LIBE, kemi konsensus që kjo të kalohet në këtë Komision deputetët kanë deklaruar se do të bisedojnë dhe do ti bindin edhe eurodeputetët tjerë, që kur të hidhet në votim në seancën plenare, pozicioni negociues të miratohet në Parlamentin Evropian.

Në Këshill ndërkohë, janë dy grupe punuese: Grupi për Ballkanin Perëndimor dhe Grupi për Liri të Brendshme, ku do te vendoset për pozicionin negociues në mes tri institucioneve dhe pastaj kalon prapë në Këshill, në nivelin e përfaqësuesve permanentë të ambasadorëve të shteteve anëtare, ku me shumicë të kualifikuar, pra 55% të ambasadorëve, duhet ta miratojnë këtë dhe pastaj futet në Parlament në seancë plenare, ku me një shumicë të thjeshtë miratohet dhe prapë kthehet në Këshill, ku janë ministrat e brendshëm. I gjithë ky proces duhet të përfundohet me negociimin dhe miratimin e traktatit, i cili duhet të nënshkruhet midis BE-së dhe Kosovës, dhe të publikohet në gazetën zyrtare, kur edhe hyn në fuqi.

Sfida mund të kemi në Këshillin e Ministrave, sepse ministrat e brendshëm tradicionalisht janë më konservativë, sidomos në debatin e fundit, që ishte lidhur me migrimin, jo pse kanë diçka kundër Republikës së Kosovës, sepse ata kanë qenë përkrahës të mëdhenj gjatë gjithë këtij procesi.

Ne në institucione kemi hartuar një Plan Veprimi, së bashku me Zyrën e Kryeministrit dhe gjithashtu do ta bëjmë edhe me Kuvendin, sidomos me Komisionin për Integrimin Evropian, që ta kemi një agjendë të saktë lobimi dhe duhet tu tregojmë vendeve anëtare të arriturat, sidomos në fushat e menaxhimit të migracionit me miratimin e pakove të ligjeve që rregullojnë çështjen e migracionit, ligje që janë hartuar në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët evropianë, të shteteve anëtare, të çilet kanë qenë përkrahës të këtij procesi.

Në fund, ministrja Hoxha, njoftoi në lidhje me dy vizitat e fundit që pati në Berlin dhe në Paris, me ç'rast kemi marrë përkrahje nga këto shtete, të cilat presin nga ne, që të vazhdojmë me reformat e integritit evropian .

Ismajl Kurteshi, tha se përkundër faktit që rekomandimi ka ndodhur, edhe ju i përmendët një seri filtrash që duhet të kalohen për të ardhur deri te liberalizimi i vizave. Natyrisht këta filtra në vendet e caktuara paraqesin edhe kërkesa të caktuara, e një ndër kërkesat mund të lidhet me atë, që në dialogun e ardhshëm Kosova të bëjë koncesione të reja ndaj Serbisë. A ka diçka të tillë dhe a duhet që disa ligje te veçanta të aprovohen, para se të merren vizat për qytetaret e Kosovës ?

Ministrja Hoxha, tha se rekomandimi ka qenë shumë i qartë. Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet që ndërlidhen me procesin e liberalizimit të vizave, nuk ka kushte shtesë, dhe ajo që po flitet se Kosovës po i kërkohet të miratohen disa ligje, nuk është e vërtetë.

Kurse, sa i përket çështjes së dialogut me Serbinë, nuk e shoh si çështje të ndërlidhur dhe dialogu nuk do të thotë koncesione të reja për liberalizimin e vizave, sepse afatet e Këshillit dhe takimet janë në shtator dhe tetor, kurse dialogu në shtator do të jetë në fazën fillestare, dhe në asnjë mënyrë procesi i liberalizimit nuk është i ndërlidhur me dialogun, MSA-në dhe nuk është i ndërlidhur me statusin e kandidatit. Çka ne duhet të bëjmë, është që deri në fund të vitit të tregojmë progres në zbatimin e MSA-së dhe ERA-s .

Kryetarja, në lidhje me marrëveshjen me Luksemburgun, që është diskutuar në mbledhjen e kaluar, pyeti ministren se në cilën fazë jemi dhe kur pritet që marrëveshja të vijë ne Komision.

Ministrja, tha se siç jemi dakorduar në mbledhjen e kaluar, përveç letrës që ju kam njoftuar, i kam shkruar edhe dy letra tjera, ku kamë kërkuar edhe përkrahjen e juaj si Komision, pra plotësim-ndryshimin e termave të referencës për Komisionin për MSA-në. Jemi në pritje të përgjigjes dhe do

t'ju njoftojë posa ta marrë ndonjë përgjigje. Besoj se më së voni deri në shtator, do të arrijmë që ta zgjidhim, që të arrijmë ta miratojmë në komisionin tuaj .

Kryetarja e falënderoi ministren për raportimin dhe vazhdoi me pikat e tjera të rendit të ditës. Në shqyrtim i kemi edhe 5 projektligje me amendamentet e komisioneve funksionale nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së. Kërkoj nga anëtarët që për shkak se seanca fillon shumë shpejtë, t'i shqyrtojmë në pako, të gjithat janë shqyrtuar dhe është konstatuar se nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

Rekomandim

1. Projektligji nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
2. Projektligji nr. 06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
3. Projektligji nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Projektligji nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Projektligji nr. 06/L-022 për Projektligjin për Ndërmarrje Sociale me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si të tilla mund të procedohen për miratim në seancën plenare.

Te ndryshme.

Ne këtë pikë nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:
Stafi mbështes i Komisionit

Kryetarja e Komisionit
Blerta Deliu Kodra
